



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. Unit Nr. i Faqeve Nr. Stranica No. Pages	DL 02 PRISHTINË / A
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No. Datum: Date:	6594-2/25 07.10.25

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Për:	Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës Bexhet Kuqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Suharekës
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në Detyrë në MAPL Jeton Qela Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Hysen Durmishi, U.D Ministër në Detyrë në MMPHI Izedin Bytyqi, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPHI
Nga:	Floriqe Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	Shendrita Latifi - Zyrtare Ligjore në Divizionin për i vlerësimin ligjor Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit dhe 2.Zyrtari hartues i Mbështetjes Ligjore vlerësimin ligjor
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal
Lloji i aktit:	Rregullorja 01-Nr-016-56044 për bonuset e zoonimit për Komunën e Suharekës, miratuar nga Kuvendi Komunal i Suharekës, datë 29.08.2025

PRIRJE - ULAZNA - INCOMING		
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO		
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije Ministry of Local Government Administration		
Datum: Date:	07.10.2025	
Njësia organizative	Nr. i Lendës	Vlera
JVI-	0-537	5

I nderuar kryetar Muharremaj,
I nderuar kryesues Kuqi

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 03.09.2025 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Rregulloren 01-Nr-016-56044 për bonuset e zoonimit për Komunën e Suharekës, miratuar nga Kuvendi Komunal i Suharekës, datë 29.08.2025.

MMPHI pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave kërkon nga Kuvendi Komunal i Suharekës:

RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT

Rregullorja 01-Nr-016-56044 për bonuset e zoonimit për Komunën e Suharekës, miratuar nga Kuvendi Komunal i Suharekës, datë 29.08.2025.

ARSYETIMI

MMPHI pas shqyrtimit të vendimit të lartcekur konstatoi se:

Vendimit i mungon arsyetimi që të justifikojë nevojën për hartimin e Rregullores për bonuset e zonimit.

Komuna e Suharekës nuk ka përmbushur obligimin ligjor të përcaktuar në Ligjin Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, neni 10 paragrafi 3 dhe neni 11 paragrafi 1 nen-paragrafi 1.14, i cili do të duhej të shërbente si bazë për nevojën e hartimit të rregullores së bonuseve të zonimit, me qëllim realizimin e qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara në dokumentet e planifikimit hapësinor, siç janë "Plani Zhvillimor i Suharekës 2021-2029" dhe "Harta Zonale e Suharekës 2022-2033" (HZK faqe 268, pika 13.3, Monitorimi i zbatimit);

Rregullorja për bonuset e zonimit duhet të jetë në përputhje të plotë me kërkesat e Hartës Zonale të Komunës, e cila është hartuar bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr. MMPH Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor;

Në "Hartën Zonale të Suharekës 2022-2033" specifikohet se "Autoriteti përgjegjës komunal mund të aplikojë bonuse të zonimit gjatë përpjekjeve për të zbatuar vijën rregulluese të planifikuar," që do të thotë se bonuse të zonimit mund të jepen vetëm për këtë rast specifik; Rregullorja e bonuseve të zonimit është në kundërshtim me Hartën Zonale të Komunës, faqe 282, pika 18, ku trajtohet interpretimi i bonuseve të zoonimit;

Përmes rregullores së bonuseve të zonimit nuk mund të përcaktohen përqindje apo përfitime të tjera nëse këto nuk janë përcaktuar në Hartën Zonale të Komunës, pasi kjo konsiderohet ndërhyrje në dokumentet ekzistuese.

Sqarim:

Tabela e ilustruar nga MMPHI/DPHNB në Projekt-Rregulloren e Bonuseve të Zonimit të Suharekës për konsultim paraprak ka pasur karakter informues dhe krahasues mes Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2033 (për përcaktimin e kushteve) dhe kërkesave të Udhëzimit Administrativ Nr. MMPH Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor (për kriteret e lejuara), dhe nuk ka qenë formë që mund të përdoret direkt në Rregulloren në fjalë.

Ne inkurajojmë Komunën e Suharekës që të zbatojë dhe monitorojë në mënyrë meritore dhe transparente zbatimin e dokumenteve në fuqi të planifikimit hapësinor, duke evidentuar sfidat dhe mundësitë në baza vjetore përmes "Raportit Monitorues të Zbatimit të Qëllimeve dhe Objektivave të Deklaruara në Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale të Komunës, si dhe Planet Rregulluese të Hollësishme," të përgatitur nga Drejtoritë sektoriale të Komunës. Këto raporte do të shërbejnë si bazë për përmirësimin dhe ndryshimin e këtyre dokumenteve pas periudhës së paraparë ligjërisht prej së paku 4 vitesh.

Nga ajo që u tha më lartë, të vepohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e Ligjit Nr. 08/ L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave.